

REVISTA VJETORE

SINDIKATA E PUNONJESVE TE POSTE-TELEKOMIT SHQIPTAR



2020 - 2021



ADRESA: Bulevardi "Bajram Curri", Nr. 29 Tiranë, Albania.

EMAIL: info@sindikata.net

FACEBOOK PAGE: Sindikata e Punonjesve Poste-Telekomit Shqiptar SPPT
<https://www.facebook.com/sindikata.postetelekomitshqiptar.3>

INSTAGRAM: @sindikata1991

Cel: +355 67 68 33 333

www.sindikata.net

NË KËTË RRUGË TË VËSHTIRË NJË FALENDERIM
SHKON PËR TË GJITHË PARTNERËT TANË!



REVISTA VJETORE E AKTIVITETIT TE SPPTSH`S

Kush jemi?

SPPTSH është një organizatë sindikale sektoriale në të cilën aderohet kryesisht punonjësit e telekomunikacionit, shërbimeve postare dhe është e hapur për të gjithë individët, sektorët privat dhe publik që i përkasin këtyre fushave apo profesioneve të tjera, si dhe sindikata të profesioneve që dëshirojnë anëtarësimin në këtë Sindikatë.

Themelimi i Sindikatës së bashkuar të PTT në të gjithë Shqipërinë u vendos në shkurt të vitit 1991, ku dy Sindikata ajo e Uzinës PTT dhe PTT Tirana mbajtën Kongresin e Parë. Nga ky kongres u zgjodhën edhe drejtuesit e parë të SPPTSH-së dhe kryetare u zgjodh znj. Rajmonda Paçuka, zv/kryetar. z. Shpëtim Vojka dhe sekretar z. Aleksandër Miraj. Që nga themelimi i saj, kjo sindikatë ka pasur si qëllim të bashkojë dhe të organizojë punonjësit, pavarësisht nga përkatësia e tyre politike, etnia, raca, profesioni, gjinia apo bindjet fetare.

Në vazhdim Sindikata është drejtuar nga të zgjedhurit në Kongreset, që ajo ka organizuar. Më poshtë po listojmë kongreset dhe kryetarët e zgjedhur ndër vite:

- Kongresi II 1995 – znj. Rajmonda Paçuka
- Kongresi III 2001- z. Aleksandër Miraj
- Kongresi IV 2005 – z. Shpëtim Vojka
- Kongresi V 2009 – z. Shpëtim Vojka
- Kongresi VI 2014 – z. Renato Muçaj
- Kongresi VII 2017 – z. Renato Muçaj

SPPTSH është një organizatë e ngritur nga aderimi mbi baza vullnetare të punonjësve, dhe ka si mision të mbrojë dhe promovojë interesat e anëtarëve të saj, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar të punës dhe të drejtat e njeriut. Sot, SPPTSH rregullon marrëdhëniet midis punëdhënësit dhe punonjësve të punësuar në Albtelecom, Makhes, Unit Center (Call Center) dhe Postës Shqiptare.

SPPTSH është e organizuar në të gjithë Shqipërinë me disa qendra rajonale. SPPTSH është anëtare në Federatën Ndërkombëtare të Sindikatave të shërbimit, UNI GLOBAL UNION, e cila është ndër më të mëdhatë dhe përfaqëson 20 milion punonjës, nga 900 sindikata në 140 vende të ndryshme.



KRYETARI I SINDIKATËS SË PUNONJËSVE TË POSTE-TELEKOMIT SHQIPTAR



Të nderuar sindikalistë të SPPTSH-së,

Revista jonë, tashmë e kthyer në një raport ku përmbledhen aktivitetet kryesore të sindikatës vazhdon të mbetet një risi për organizatat sindikaliste në Shqipëri. Sot ne botimin e tij të 5-të, kjo revistë filloj të botohej nga sindikata për herë të parë në vitin 2016. Kjo është një mënyrë e mirë për të komunikuar me të gjithë anëtarët tanë dhe për të arkivuar për të gjithë brezat e ardhshëm aktivitetet e sindikatës ndërvite. Pavarësisht se aktivitetet tona pasqyrohen në kohë reale si në rrjete sociale ashtu dhe në faqen tone të web-it (www.sindikata.net) ky raport është një mundësi e mirë informimi për të gjithë punonjësit, partneret dhe bashkëpunorët që duan të informohen në mënyrë të përmbledhur mbi punën tonë.

Viti 2020 ishte një vit pandemik ku sfidat për sindikatën ishin vërtet të paparashikueshme. Sfida kryesore ishte mbrojtja e jetës së punonjësve dhe marrjen e masave të menjëhershme për tu pajisur me masa mbrojtëse. Sindikata e Punonjësve të Postë-Telekomit Shqiptar (SPPTSH), duke vërejtur përhapjen e shpejtë të virusit COVID-19 në Shqipëri kërkoi një reagim urgjent për të mbrojtur shëndetin në punë, vendet e punës dhe stimuluar ekonominë. Duke vlerësuar punën e autoriteteve për luftën që po zhvillohej për të ndaluar përhapjen e virusit dhe duke qenë se situata e karantines pritej të zgjaste, ishte e qartë që të mbroje tërë shoqërinë do të thoshte të mbroje njerëzit në punë. Punonjësit e sektorit tonë ishin në vijën e parë të ndikimeve ekonomike, sociale dhe shëndetësore të COVID-19. Ju drejtuam me një deklaratë Qeverisë dhe Punëdhënësve për marrjen e masave për të mbrojtur punonjësit e sektorit tonë. Marrëveshjet kolektive sigurojnë kontekstin gjithëpërfshirës dhe të adaptueshëm për marrjen e këtyre vendimeve të përbashkëta. Mos respektimi i tyre mund të risë përhapjen e virusit. Angazhimi jonë bashkë me punëdhënësit bëri që punonjësve t'u jepen mjetet e nevojshme çdo ditë që paraqiteshin në punë, ju gargantua disinfektimi i ambienteve të punës, ju mundësua puna nga shtëpia dhe mbulimi me page të plote për të gjithë punonjësit e karantinuar.

Viti 2021 ishte një vit shumë i rëndësishëm dhe i sukseshëm pasi gjatë këtij viti mbas një pune të gjatë 14 mujore është arritur firmosja e kontratës kolektive për rreth 3800 punonjës të kompanisë Teleperformance të cilët do të kenë një zë zyrtar përfaqësues dhe një kontratë kolektive që do t'u mundësojë kushte më të mira pune dhe benefite financiare. Gjatë negociatave SPPTSH ka punuar dhe është munduar për të arritur të gjitha kërkesat e punonjësve. Ky sukses sigurisht i dedikohet të gjithë punonjësve dhe përfaqësuesve të sindikatës që u përfshinë në procesin e organizimit.

Një nga qëllimet kryesore të sindikatës është mbrojtja e të drejtave të punonjësve. Sigurisht që mekanizmi më i rëndësishëm ligjor që disponon sindikata është kontrata kolektive e cila është një garanci themelore për të gjithë punonjësit. Kontrata kolektive nuk është vetëm forma ligjore që nënshkruhet midis punëdhënësit dhe sindikatës por është dhe guri kilometrik për zhvillimin e mëtejshëm të dialogut social midis palëve në këtë proces. Me firmosjen e kontratës kolektive SPPTSH, jo vetëm ka përmbushur një nga detyrat e saj por ka siguruar standarte më të larta pune për të gjithë punonjësit. Prandaj ky vit ka për tu shënuar si një vit historik ku për herë të parë në historinë e sindikalizmit shqiptar firmoset një kontratë kolektive në sektorin e call centerave me një kompani ndërkombëtare duke e kthyer edhe këtë vend pune në një vend pune të denjë.

Sot me këtë zgjerim sektorial të sindikatës përmbushim përpara kongresit tone të 8-të një nga pikat e planit strategjik të miratuar në Kongresin e VII-të të SPPTSH-së (10 Shkurt 2017), për një përfaqësim sa më sektorial të sindikatës sonë. Kur prezantuam strategjinë e re të sindikatës sonë shumë ishin skeptik në realizimin e kësaj strategjie por vullneti dhe puna jonë e vazhdueshme bëri që kjo strategji jo vetëm të ishte e duhura por të implementohej me sukses. Ndryshimet statutores të miratuara në Kongresin e VII-të i mundësojnë sindikatës që tashmë mos të jetë e hapur vetëm për kompanitë e sektorit por të jetë e hapur për të gjithë individët, sektorët privat dhe publik që i përkasin këtyre fushave apo profesioneve të tjera, si dhe sindikata të profesioneve që dëshirojnë anëtarësimin në këtë Sindikatë.

Në kuadër të strategjisë, gjatë këtij viti përveç rritjes sektoriale i është kushtuar shumë rëndësi organizimit të brendshëm, rritjes së kapaciteteve dhe shëndrimit të sindikatës në një zë publik për të gjithë punonjësit e sektorit.

Një numër i lart aktivitetesh sindikale janë zhvilluar gjatë vitit 2020-2021 duke u fokusuar te organizimi i brendshëm, rritja e kapaciteteve dhe forcimi i bashkëpunimit si me partnere vendas dhe të huaj. Janë zhvilluar një seri trajnimesh për përfaqësuesit e zgjedhur të sindikatës dhe punonjësit tanë në të gjithë Shqipërinë. Këto trajnime të zhvilluara në bashkëpunim me fondacionin suedez Olof Palme kanë pasur në fokus rritjen e kapaciteteve për të gjithë punonjësit dhe forcimin e sindikatës. Por për të marr opinionin e tyre janë përdorur edhe takime një-me-një dhe anketime online. Të gjitha këto problematika të mbledhura i janë paraqitur drejtuesve të kompanive respektive.

Në vazhdim të planit të miratuar nga Këshilli Kombëtar për të vitalizuar anëtarësinë e SPPTSH-së janë zhvilluar dhe shumë aktivitete social-kulturore. Gjithashtu me fondacionin gjerman Friedrich Ebert është zhvilluar një studim i thelluar ku ne si sindikate kemi qene pjese e ketij studimi ne lidhje me stresin ne vendin e punes.

Një rëndësi të veçantë për ne si sindikatë ka dhe bashkëpunimi me partnerët tanë kombëtar dhe ndërkombëtar i cili edhe gjatë kësaj periudhe nuk ka munguar. Prandaj gjej rastin të falenderoj edhe njëherë, Fondacionin gjerman FES, fondacionin suedez OPC, partnerin tonë strategjik sindikaten gjermane Ver.di, "Solidarity Center" dhe çdo partnere tjetër me të cilin kemi bashkëpunuar gjatë kësaj periudhe. Një falenderim dhe vlerësim u takon të gjithë kolegëve të strukturave të SPPTSH-së, që kanë punuar me seriozitet për të përfaqësuar denjësisht të gjithë punonjësit e seksioneve dhe rajoneve të tyre.

Gjithsesi dua të theksoj edhe njëherë se puna jonë për të rritur dhe forcuar sindikatën do të vazhdojë. Ne do të vazhdojmë të luftojmë për të ndërtuar një sindikatë moderne në shërbim të të gjithë anëtarëve. Sa më shumë të solidarizohemi me sindikatën aq më shumë i shërbejmë zgjidhjeve të kauzave tona. Pasi Sindikata është njësoj si ekipi juaj i futbollit që futet në fushën e lojës vetëm për të fituar pavarësisht se si përfundon ndeshja.

Ndërsa anëtarët janë tifozët e saj të zjarrtë që e ndihmojnë në çdo ndeshje. Prandaj mbështetja për sindikatën duhet të jetë gjithmonë pa kushte njësoj si mbështet skuadra e zemres në stadiun. Sindikata është ekipi jonë fitues !

Sinqerisht,
Renato MUÇAJ
Kryetari SPPTSH-së





FIRMOSET KONTRATA KOLEKTIVE ME “TELEPERFORMANCE ALBANIA”

Ne Shtator te vitit 2020 SPPTSH filloj takimet e para me punonjes ne Teleperformance Albania.

Keto takime u fokusuan ne identifikimin e problematikave te punonjesve dhe kerkesat e tyre.

Synimi i SPPTSH-se ishte ngritja e nje rrjeti dhe identifikimi i liderve midis ketyre punonjesve qe do te intensifikonin informimin e punonjesve brenda kompanise. Pandemia dhe puna nga shtepia ishin dy nga sfidat qe veshtiresonin komunikimin me punonjesit. Sindikata hyri ne bisedime me kompanine dhe kerkoi qendrimin neutral te saj ne kete proces organizimi.

Vetem mbas disa takimesh u arrit nje marreveshje neutraliteti me kompanine qe i dha mundesine sindikates te intensifikonte punen e saj brenda kompanise. Mbas nje pune 8 mujore u arrit qe te identifikoheshin kerkesat e punonjesve dhe nje numer i konsiderueshem punonjesish te anetaresheshin ne sindikate.



Teleperformance

each interaction matters

Ne perfundim te ketij procesi SPPTSH mori vendimin qe te depozitonte prane kompanise kerkesen per fillimin e bisedimeve kolektive. SPPTSH u kujdes qe te gjithe procedurat e afishimit te kryheshin ne perputhje me kodin e punes dhe punonjesit te informoheshin mbi procesin e bisedimeve.



Mbas depozitimit te kerkeses per lidhjen e kontrates kolektive u zhvillua takimi i pare per fillimin e bisedimeve per lidhjen kontrates kolektive me kompanine Teleperformance Albania qe puneson rreth 3800 punonjes. Sindikata jone i parashtrojë kompanisë kerkesat e punonjesve duke filluar me rritjen e pagave, njesimin e pagave te operatoreve te Duresit me operatoret e Tiranës.



Kerkesat e tjera ishin mbi lejet prinderore, problemet e pandemise dhe shume problematika te tjera te dala gjate takimeve me punonjesit. Sindikata, kërkoj gjithashtu që të vazhdojnë bisedimet dhe diskutimet për cdo nen të kontratës nga ekipet përkatëse gjë që u pranua nga Kompania Teleperformance Albania. Takimi i ardhshëm do të përcaktonte draftin fillestar të kontratës kolektive mbi të cilin do të vazhdojnë bisedimet e mëtejshme. Në të njejten kohe që SPPTSH vazhdonte përgatitjet për kontratën kolektive vazhdonte dhe takimet si në Tiranë dhe Durrës për të konsultuar të gjitha pikat që do të paraqiteshin në vazhdim në negociatë. Negociatat vazhduan përtej parashikimeve pasi jo vetëm kishte mos dakortësi për pikat që sindikata kishte propozuar por edhe disa "Sindikata" që mbinin si kerpudha mbas shiut hidhnin genjeshtrat e tyre lartë e poshtë. Pavarësisht këtyre pengesave SPPTSH vazhdoi betejën e saj për të çuar deri në fund realizimin e kërkesave të punonjesve duke i garantuar të gjithë se **"GËNJESHTRA I KA KËMBËT E SHKURTRA"**. Sindikatat e rrjeteve sociale, por dhe të gjitha palet e tjera tani janë përpara fakteve se sindikata jonë ka punuar me këmbengulje për plotësimin e kërkesave të punonjesve të Teleperformance.

Mbas një pune të gjatë 14 mujore në muajin Nentor 2021 është arritur firmosja e kontratës kolektive për rreth 3800 punonjës të kompanisë Teleperformance të cilët do të kenë një zë zyrtar përfaqësimi dhe një kontratë kolektive që do tju mundësojë kushte më të mira pune dhe benefite financiare. Gjatë negociatave SPPTSH ka punuar dhe është munduar për të arritur të gjitha kërkesat e punonjësve. Ndër më kryesoret ishin rritja e pagave, vecanërisht rritja e nivelit minimal të pagave për punonjësit e Durrësit.

Pavarësisht vështirësive të hasura gjatë negociatave, më në fund kemi arritur që të sigurojmë për punonjësit nga kontrata kolektive:

1. Paga minimale orare për operatorët nga 220 lekë/neto do të rritet gradualisht si vijon:
 - a. Përgjatë vitit 2022 paga minimale = 250 lekë/orë neto.
 - b. Përgjatë vitit 2023 paga minimale = 280 lekë/orë neto.
 - c. Përgjatë vitit 2024 paga minimale = 310 lekë/orë neto.
 - d. Punëdhënësi do të rrisë pagën minimale për operatorët edhe mbi këto nivele në varësi të vjetërsisë së tyre në punë.
2. Punëdhënësi çdo muaj Gusht të vitit pasardhës do të hyj në bisedime me sindikatën për rishikimin e nivelit të pagave duke marrë për bazë inflacionin dhe rrethana të tjera.
3. Punëdhënësi do të jap një shperblim prej 6000 (gjashte mijë) Lekë , në fund të çdo viti kalendarik, për punonjësit që kanë plotësuar 2 vjet vjetërsi në punë.
4. Në varësi të vjetërsisë në punë, lejes vjetore (4 javë kalendarike) do të shtohen ditët si më poshtë:
Vjetërsia në punë = Ditët që shtohen
2-5 vite pune = 1 dite pushim
Mbi 5 vite pune = 2 dite pushim
5. Për përgatitjen dhe mbrojtjen e titujve pasuniversitar si dhe trainimeve të ndryshme në lidhje me profesionin që ushtron, me miratimin paraprak të Punëdhënësit, Punëmarrësi përfiton 5 dite pushim të paguar në vit.
6. Punëdhënësi i jep shperblim Punëmarrësit 1 (nje page) mujore ne rast vdekje te vete Punemarresit.
- Punëdhënësi jep shperblim deri në masën prej 2 (dy) pagash në rast vdekje te Punëmarresit në punë.
7. Punëdhënësi i jep shperblim Punëmarrësit 1 (nje page) mujore me rastin e daljes në pension.

Së bashku jemi më të forte!

TAKIME ME PUNONJESIT NE VENDIN E TYRE TE PUNES

Sindikata e Punonjesve te Poste -Telekomit Shqiptar ne bashkepunim me Olof Palme International Center, ka ndermarr nje fushate per te vizituar ne vendet e punes nje pjese te punonjesve per te diskutuar nga afer dhe per te identifikuar problematikat me te cilat ata perballen cdo dite ne vendin e tyre te punes. Takimet jane zhvilluar ne 7 Rajone, ne 11 Qytete dhe ne shume vende pune. Kjo fushate shtoi ndjeshem numrin e anetareve, pasi nepermjet takimeve u arrit t'ju shpjegohet cdo punonjesi se i vetmi mjet qe ne kemi per te adresuar problemet tona eshte sindikata. Te gjitha problemet e mbledhura nga punonjesit sindikata i ka depozituar prane kompanive perkatese dhe ka kerkuar menjehere nderhyrjen per te zgjidhur cdo shqetesim te tyre pasi ne jemi gjithmone zeri qe lufton per punonjesit! Ne fillim perfaqesuesit e sindikates jane ndalur te punonjesit e nje prej sektoreve te Makhes ne Tirane. Duke qene nje nga pozicionet me te veshtira te punes ne sektorin e telekomunikacionit Kryetari i Sindikates z. Renato Mucaj eshte ndalur posacerisht per te diskutuar problematikat ditore te ketij sektori dhe menyren e zgjidhjes se tyre. Per te gjitha propozimet kolektive te teknikeve te rrjetit te telekomunikacionit, sindikata u zotua qe do te kerkoj plotesimin e tyre si te punedhenesi Makhes Albania por edhe prane kompanise kontraktuese Altelecom.






TAKIME ME PUNONJESIT

Sindikata ne bashkepunim me Olof Palme International Center ka vazhduar me tej me takimet ne rajonet e tjera per te rritur dhe forcuar strukturat sindikale dhe per te identifikuar problematikat e punonjesve. Takime te ndryshme jane zhvilluar me punonjes te teknikes dhe shitjeve ne rajone te ndryshme si ne Vlore, Gjirokaster, Elbasan, Shkoder, Fier, Tepelene, Sarande dhe Tirane. Gjate ketyre takime jane vizituar punonjes ne dyqanet e AlBtelecom dhe ne terren ku ata punojne. Punonjesit jane informuar mbi kontraten kolektive dhe te gjitha zhvillimet dhe aktivitetet qe sindikata ka zhvilluar se fundmi. Shume punonjes te rinj jane bere pjese e SPPTSH gjate kesaj fushate ku te gjitha e kane kuptuar me se mire se i vetmi mjet per ti perfaqesuar perpara punedhenesit eshte sindikata.








KERKESAT E PUNONJESVE DHE ARRITJET E SPPTSH

Sindikata e Punonjësve të Postë Telekomit Shqiptar, prej kohësh e ka fokusuar punën në terren duke takuar nga afër punonjësit. Pas takimeve me punonjësit, në 11 Dhjetor 2020 - Kryetari i Sindikatës në një takim Virtual me CEO-në e Albtelecom z. Tahsin Yilmaz i ka ngritur të gjitha shqetësimet e punonjësve të mbledhura gjatë takimeve në terren me sindikatën. Ai ka kërkuar zgjidhje të menjëhershme për të gjitha kërkesat. Gjatë takimit, CEO ka kërkuar që këto kërkesa të adresohen në formë të shkruar për tu ndjekur me departamentet përkatëse, ku janë kërkuar:

- Ndryshimi i Target - Bonusit (për shopet)
- 4 orë pushim drekte gjate Ditëve të Festave (për shopet)
- Promovimi dhe Vlerësimi i Punonjësve me Eksperiencë
- Dhënien e trajtimit ushqimor për punonjësit që punojnë nga shtëpia.
- Rritjen e nivelit te pagave (per punonjesit ne call center)
- Shtimin e operatorëve të tjerë për të përballuar fluksin (për call center)
- Organizimin e turneve në bazë mujore (për punonjësit e call center)
- Shpërblimin e fundvitit të parashikuar në kontratën kolektive
- Rritja e pagave, duke marrë për bazë normën e inflacionit



Dokumentin e plotë në variantin shqip/anglisht të derguar pranë kompanisë, është ndarë me të gjithë punonjësit dhe mund ta gjeni në websiten tonë www.sindikata.net.

Sindikata gjithashtu i ka drejtuar leter me kerkesa dhe kompanise Makhes Albania ku nder te tjera jane kerkuar:

1. Rritjen e pagave duke u bere nje page dinjitoze per tregun e punes te telekomunikacionit.
2. Identifikimin dhe pagesen e oreve jashte orarit te cilat nuk paguhen rregullisht.
3. Informimi mbi perlllogaritjen e pages dhe oreve jashte orarit, detyrim ligjor, parashikuar ne nenin 119 te Kodit te Punes.
4. Permiresimi i Kushteve te punes ku te respektohet sigurimi teknik dhe furnizimi rregullisht me vegla pune.
5. Dita e diele te jete pushim per te gjithë tekniket.

KERKESAT E PUNONJESVE DHE ARRITJET E SPPTSH-se

Sindikata gjithmonë i ka inkurajuar të gjithë punonjësit që të raportojnë për problemet që ata mund të kenë në vendin e tyre të punës. Vetëm të organizuar dhe me adresimin e kërkesave në vendin e mënyrën e duhur mund të gjejmë zgjidhje!

SINDIKATA JE TI! SOLIDARIZOHU, ORGANIZOHU ANETARESOHU!

2020-2021-shi ishte i mbushur me sfida por ja kemi dal të organizojmë vende të reja pune dhe t'ju mundësojmë më shumë të drejta punonjësve me anë të kontratave kolektive. Përveç se rritëm njohuritë e punëtorëve për të drejtat e punës, kontratat kolektive dhe sindikatat u arrit gjithashtu :

1. Rritja e pages me 10,000 lekë për punonjësit e call center të Albtelcom, duke u rritur nga 30,000 në 40,000 lekë.
2. Jane indeksuar pagat duke marre per baze inflacionin dhe ka pasur permiresime pagash per tekniket e rinj te Makhes Albania.
3. Gjatë pandemisë teknikeve të Makhes ju dhanë masa mbrojtëse falas dhe një bonus prej 3000 lekësh për secilin nga teknikët.
4. Me ndërhyrjen e sindikatës u vendos që punonjësit e Albtelcom të punojmë me një orar fleksibel dhe jo fiks qe ju jep nje mundesi lehtesimi te gjithë punonjesve ne perditshmerine e tyre.
5. Të gjithë punonjësit e Teleperformance Albania perfituan nje shperblim ne fund te vitit 2021 prej 6,000 Lekë.
6. Të gjithë punonjësit e Makhes Albania perfituan nje shperblim ne fund te vitit 2021 prej 5,000 Lekë.
7. Të gjithë punonjësit e Albtelcom perfituan nje shperblim ne fund te vitit 2021 prej 20,000 Lekë. Pavarësisht situates aktuale të tranzicionit ku kompania Albtelcom ndodhet një falenderim i shkon dhe CEO-s së Albtelcom znj. Bilgen Aldan që u angazhua personalisht për të zgjidhur kërkesën e sindikatës për shpërblimin e fundvitit.




Viti 2022 do të jetë akoma më sfidues për shkak të ndryshimeve në tregun e telekomunikacionit, ku dy prej kompanive janë blerë nga grupi hungarez 4IG. Ndërsa në sektorin e call center, sfida do të mbetet pandemia dhe puna nga shtëpia.

TRAJNIME ME PERFAQESUESIT E SINDIKATES

1 Korrik 2020 - SPPTSH ne kuader te bashkepunimit me Olof Palme Center ka zhvilluar trajnimin e rradhes me perfaqesuesit e sindikates per monitorimin e kontratave kolektive. Ky trajnim kishte ne fokus kontratat kolektive te lidhura nga SPPTSH dhe udhezimin e te gjithe perfaqesuesve se si duhet te veprojne ne rastet kur evidentohen shkelje te kontrates kolektive. Gjithashtu atyre ju dhane udhezime teknike sesi do veprohet me fushaten e anetaresimeve gjate kohes se pandemise dhe ju prezantua formati i ri i formularit te anetaresise qe do te perdoret ne vazhdim nga sindikata.



20 Qershor 2021 - SPPTSH ka zhvilluar nje trajnim per ngritjen e kapaciteteve te perfaqesuesve te sindikates mbi ceshtjet e organizimit dhe fuqizimit te sindikates. Ne kete trajnim kane marr pjese perfaqesues te sindikates ne kompanite Albtelecom, Makhes, BTC dhe Teleperformance.





...me ne të parët!

Vetëm me punonjës të kënaqur ne mund të kemi vende pune dinjitoze, të frenojmë largimin e fuqisë punetore, të rrisim ekonominë dhe të kemi një Shqipëri më të mirë dhe më sociale. Në punonjësit meritojmë të respektohemi dhe të trajtohemi mirë kudo ku punojmë. Çdo punëdhënës, nga kompanitë më të vogla deri në korporatat më të mëdha, apo në administratën shtetërore, lokale dhe të qarkut, duhet të na trajtojë me dinjitet dhe respekt, duke siguruar kushte të mira pune dhe një pagë dinjitoze për përmirësimin e standardeve sociale ekonomike të punëmarrësve. Për fat të keq, shumë punëdhënës janë kaq të shqetësuar për fitimet e tyre dhe në fund nuk arrijnë të shohin mirëqënien, kënaqësinë apo kontributin tonë.

Prandaj Sindikata thekson se vetëm me punonjës të kënaqur ne mund të jemi të parët në çdo sektor të ekonomisë prandaj ne synojmë që nëpërmjet fushatës ndërgjegjësuese “Me ne të parët” të rrisim ndërgjegjësimin e publikut për vende të denja pune jo vetëm në sektorin e shërbimit të komunikimit dhe teknologjisë së informacionit por dhe në të gjithë sektorët e tjerë. Është tepër e nevojshme që të gjithë punonjësit të informohen se si mund të rriten kushtet e punës, pagat apo mirëqënia e tyre në vendet e punës dhe si mund të arrihen të gjitha këto nëpërmjet organizimit sindikal dhe kontraktimit kolektiv.

Nga eksperiencat në terren na rezultojnë se shumë punonjës nuk kanë informacionin e duhur ose kanë një opinion të gabuar rreth sindikatave duke harruar se në të gjitha vendet e zhvilluara sindikatat luajnë një rol thelbësor në ekonominë e vendit dhe janë pjesë e vendimarrjeve politike duke shërbyer si një nga shtyllat e demokracisë. Duke shfrytëzuar teknologjitë dixhitale (media sociale, website, etj.) por dhe medianë kemi si qëllim jo vetëm informimin por edhe ndërgjegjësimin e të gjithë punonjësve mbi ndikimet e dëmshme të dixhitalizimit, privatizimit, derregullimit, nënkontraktimit, offshoring apo edhe pandemisë. Fushata do të fokusohet gjithashtu në promovimin e lirisë së asociimit, dialogut social dhe ndërgjegjësimin për shkelje të ligjit duke mbajtur përgjegjësinë qeverinë dhe punëdhënësit. #meneteparet

FUSHATA ME NE TË PARËT!

STRESI NË VENDIN E PUNËS

Fondacioni "Friedrich Ebert" në bashkëpunim me "Olof Palme International Center" kanë prezantuar studimin "Stresi në vendin e punës". Në këtë studim është përfshirë dhe SPPTSH, ku anëtar të sindikatës si ne Albtelcom dhe Makhes kanë plotësuar pyetsorin e përdorur në studim. Prezantimi i studimit është bërë në mjediset e hotel Rogner ku ka qene i pranishem kryetari i SPPTSH-se dhe perfaqesues te tjere te sindikates qe kane pasur mundesi ta ndjekin online. Ky studim ka hapur një diskutim për një aspekt që nuk merret shumë parasysh nga sindikatat gjatë nenshkrimet të kontratës kolektive. Stresi në vendin e punës është një fenomen global, që prek një numër të konsiderueshëm të profesioneve dhe moshave të ndryshme. Në dekadat e fundit ky fenomen duket se është ndikuar dhe nga ndryshimet, që kanë ndodhur në tregun e punës, të cilat përfshijnë teknologjitë e reja të komunikimit dhe shpërndarjes së informacionit, larmishmërinë e pozicioneve të punës dhe rritjen e ngarkesës psikologjike.

"STRESI NË VENDIN E PUNËS"
25 Mars 2021
10:00 AM

STINE KLAPPER
Perfaqesuese e Fondacionit Friedrich-Ebert-Stiftung Tirana

JOHAN SCHMIDT
Menaxher Programi Rajonal Olof Palme International Center

RENATO MUCAJ
President i Sindikatës së Punonjësve të Postë-Telekomit

GJERGJ BUXHUKU
Administrator i Përgjithshëm i Konfederalizisë

FATOS COCOLI - MODERATOR

KLODIAN GEGA - AUTOR I STUDIMIT

FRIEDRICH EBERT STIFTUNG **OLOF PALME INTERNATIONAL CENTER**

Stresi në punë është vënë prej kohësh në vëmendjen e organizmave ndërkombëtarë të shëndetit apo të punës, siç janë Organizata Botërore e Shëndetësisë apo Organizata Ndërkombëtare e Punës. Kjo për faktin se ai ka një ndikim serioz si në shëndetin e punonjësve dhe cilësinë e jetës së tyre ashtu edhe në nivelin e performancës së punës.

Stresi në punë nuk është një proces i thjeshtë për t'u matur. Kjo jo vetëm për faktin se ai është i vështirë të përkufizohet por edhe sepse përmban elemente subjektive që janë të ndryshëm nga një person te tjetri. Bazuar në gjetjet e studimit, një përqindje e konsiderueshme e njerëzve të përfshirë në studim (48.5%) përjetojnë një nivel të moderuar stresi dhe një përqindje jo e vogël,

nisur kjo nga efekti negativ që ka stresi në përditshmërinë e punonjësve (12.4%), përjetojnë nivel problematik stresi. Ky rezultat tregon se stresi i lidhur me punën ka një prevalencë të lartë tek punonjësit në Shqipëri. Faktorë si presioni i kohës; paqartësia e rolit; mungesa e promovimit; vështirësia në delegimin e punëve; puna jo e mirë në grup; trajtimi i pabarabartë në punë; angazhimi në detyra të vështira; dhe niveli ulët i pagës, ndikojnë në rritjen e nivelit të stresit tek punonjësit. Studimin e gjeni në www.tirana.fes.de

STRESI NË VENDIN E PUNËS

Studim mbi nivelin e stresit dhe faktorët që ndikojnë në rritjen e tij të punonjësit shqiptarë

Autor: Klodian Gega
Qendër për Shqipëri dhe Ballkanin Jugor të Ineqzimit

FRIEDRICH EBERT STIFTUNG **OLOF PALME INTERNATIONAL CENTER**



30 VJET FONDACIONI GJERMAN "FRIEDRICH EBERT"

FES, nje nga partneret tane strategjik mbushi kete plot 30 vite aktivitet ne Shqiperi. Kontributet qe FES i ka dhene Shqiperise jane te panumer-ta. Roli fondacionit ka qene kyc per zhvillimet demokratike, politike, sociale dhe sindikaliste. Partneriteti jone me FES daton qe ne 2015 ku kontributet per rritjet e kapaciteteve dhe mbeshtetjet e drejtperdrejta nuk kane munguar. Bashke me FES eshte rritur edhe SPPTSH. Ne kemi qene dhe mbetemi nje nga partneret e Fondacionit qe vazhdon te jap kontributin e tij ne mbeshtetjen dhe fuqizimin e levizjes punetore ne Shqiperi. Ne kete 30 vjetor i cili fatkeqesisht zhvillohej ne kushte pandemie ne mjediset e Hotel Rogner, SPPTSH perfaqesohej nga kryetari z. Renato Mucaj . Ne kete event merrte pjese kryeministri i Shqiperise z. Edi Rama, deputet gjerman, ambasador, perfaqesues te partive politike, sindikatave dhe organizata te tjera te shoqerise civile.




KESHILLI KOMBETAR I SPPTSH

Pavarësisht


dy viteve të pandemisë 2020-2021, ku sfidat kanë qenë të ndryshme, sindikata në mbështetje të neneve 19 dhe 20 të Statutit të saj është mbledhur rregullisht për të zhvilluar mbledhjet e Këshillit Kombëtar. Në përputhje me statutin e sindikatës, janë zhvilluar 4 mbledhje ne datat 17 KORRIK 2020 në Tiranë, 18-19 DHJETOR 2020 në Tiranë, 5 QERSHOR 2021 ne Përmet dhe 17 DHJETOR 2021. Mbledhjet e Këshillit Kombëtar janë mbajtur me këtë rend dite:

- 1- Informacion i Përgjithshëm për aktivitetin e Sindikatës.
- 2- Diskutim dhe raportim i perfaqesuesve mbi situatën në Departamentet / Rajonet e tyre.
- 3- Fushata të Organizimit.
- 4- Raportime dhe plani për 6 mujorin e ardhshëm.
- 5- Diskutim i lirë mbi problematika të tjera.


Ne të gjitha mbledhjet është bërë një analizë e aktiviteteve, janë dhënë raporte dhe informacione nga drejtuesit e SPPTSH-se dhe janë lënë detyra për 6-mujoret në vazhdim. Kryetari i SPPTSH-se ka theksuar në mbledhje se është nevojë përsosë për një perfaqësim sa më dinjitoz që çdo anëtar i keshillit të ketë njohje të plote të statutit të sindikatës, kontratave kolektive dhe të drejtave që rrjedhin nga këto kontrata. Çdo perfaqësues duhet të angazhohet në fushatat e antaresimeve për të thithur në sindikate të rinj që hyjnë rishtazi në punë. Thëksi në çdo mbledhje është vënë mbi rritjen e antaresimeve, perfaqësimin dinjitoz në çdo seksion dhe rajon, si dhe monitorimin e kontratës kolektive. Mbas raportimit dhe analizës së aktivitetit sindikal është rishikuar edhe njëherë dokumenti i strategjisë së sindikatës 2017-2022. Kryetari, ka kërkuar angazhimi e të gjithëve për realizimin e objektivave të vendosura.




Shpenzime Administrative / Informative
Organizimi / Pajisje Kancelarie
Sherbime / Ndhme Sociale



Perfaqesime Kombetare / Nderkombetare
Kuotat Nderkombetare
Pritje Delegacionesh



Seminare / Trajnime
Aktivitete Sociale per Anetaret
Konferenca



Kryesia / Keshilli Kombetar

KESHILLI KOMBETAR I SPPTSH

Pas miratimit te ndryshimeve ne planin e strategjise, eshte diskutuar per projektin “Nje sindikate per te gjithë” dhe ecurine e tij. Diskutime ka pasur dhe mbi problematika te tjera te cdo seksioni dhe rajoni te sindikates qe jane adresuar nga anetaret e keshillit sipas seksionit apo rajonit te tyre.

Sindikata ke nderrmar nje hap per te pasur nje databaze dixhitale ku se shpejti do te jete ne perfundim dhe ne funksion te sindikates per te lehtesuar punen e saj. Ne te njejten kohe sindikata ka publikuar edhe formularin e saj te anetaresise dhe eshte duke punuar qe te kete nje formular online per tu plotesuar me lehtesishte per te gjithë ata qe punojne nga shtepia.

Nje nga mbledhjet e Keshillit Kombetar eshte zhvilluar ne Qytetin e Permetit, nje menyre e gjetur nga SPPTSH per te pasur nje pjesmarrje me te gjere dhe per te aktivizuar dhe anetaret e sindikates ne rrethe te cilet jane ftuar per te marre pjese ne punimet e mbledhjes se keshillit kombetar. Te gjithë pjestaret e kane mbeshtetur kete iniciative te SPPTSH dhe kane kerkuar qe organizime te tilla te jene me te shpeshta.

Ne mbledhjen e fundit te Keshillit Kombetar te eshte zhvilluar ne Tirane, jane marre dhe vendimet qe do ti paraqiten Kongresit te 8-te te SPPTSH-se. Keshilli ne menyre unanime ka votuar qe kandidati per Kryetar te jete z. Renato Mucaj. Kongresi eshte vendosur te mbahet ne dt.4 Mars 2022 ne Tirane.



**SPPTSH
disponon 4
Kontrata
Kolektive**

ALBTELECOM --> 2019 - 2023

MAKHES --> 2019 - 2022

UNIT CENTER --> 2019 - 2022

TELEPERFORMANCE --> 2021 - 2026

"DEMOCRACY TALK" NË AMBASADËN SUEDEZE

Kryetari i SPPTSH-se z. Renato Mucaj, me ftese te Ambassadors se Suedise znj. Elsa Håstad, mori pjese ne takimin "Democracy Talk" organizuar ne rezidencen e Republikes se Suedize. Ne kete takim merrnin pjese aktor te ndryshem si perfaqesues te qeverise biznesit sindikatave, Olof Palme Center dhe organizata te shoqerise civile. I ftuari i nderit perfaqesuesi i IFMETAL Z.Besim Matoshi referoj per te drejtat e punes dhe modelin suedez. Z. Mucaj kerkoj qe sindikatat te bashkepunojne me shume me njera tjetren dhe te organizohen jo ne nivel ndermarrje por ne nivel sektorial ku modeli suedez me kontrata kolektive sektoriale mund te sherbej si nje referim per Shqiperine.



June 23, 2021

17:00- 19:30

The Swedish Residence



Embassy of Sweden in Albania presents

Democracy Talk:

**Inclusive and Sustainable Economic Development
-The case of Sweden**

All women and men should exercise their right as economic actors to fully participate in, contribute to and benefit from economic development without limiting the next generation's possibilities for the same.

Independent and strong social partners in Sweden have helped build one of the most innovative and equal economies in the world.

Mr Besim Matoshi, Member of IF Metall's Federal Board, the largest trade union in Sweden, will bring the experience of the Swedish model and his engagement in Albania followed by a discussion moderated by Swedish Ambassador, Ms. Elsa Håstad on how all actors can join forces for an inclusive and sustainable development in Albania and creating a win-win situation for workers, for employers and for societies.



Besim is born in Kosovo and has lived in Sweden since 1986. Besim's family moved to Sweden when he was only 4 years old. Since 2005 Besim worked with negotiations and development through various roles within old Metall and today's IF Metall.

Besim worked as chairman of IF Metall in the Gnosjå region and there the union had agreements with 460 companies and 9,500 members (small companies). Overall, IF Metall has 320 000 members and 37 collective agreements covering 12 500 companies. He left the role as chairman on 31 May 2021 and is currently assigned as organisational leader for the trade union-political centre within IF Metall. In Albania, Besim has supported the organisational development of CLR (Center for Labour Rights) and of new trade unions.



DEKLARATË

COVID-19 – Masat urgjente për vendet e punës dhe ekonominë - 16 mars 2020



Sindikata e Punonjësve të Postë-Telekomit Shqiptar (SPPTSH), duke vërejtur përhapjen e shpejtë të virusit COVID-19 në Shqipëri kërkon një reagim urgjent për të mbrojtur shëndetin në punë, vendet e punës dhe stimuluar ekonominë. Ne vlerësojmë punën e Qeverisë për luftën që po zhvillon për të ndaluar përhapjen e virusit dhe mbështjen financiare të akorduar për punën e palodhur të stafit mjekësor për të përballuar këtë emergjencë kombëtare. Gjithsesi duke qenë se situata e karantines pritet të zgjasë, është e qartë që të mbrosh tërë shoqërinë do të thotë të mbrosh njerëzit në punë. Qeveria, punëdhënësit dhe sindikatat duhet të veprojnë për të mbrojtur punonjësit dhe për të trajtuar transmetimin e virusit në vendet e punës.

Punonjësit e Telekomunikacionit, Postave, Qendrave të Thirrjeve (Call Center) dhe të gjithë punonjësit në të gjithë sektorët e shërbimeve, shumë prej të cilëve janë në kontakt me shumë njerëz në punën e tyre të përditshme, tani e gjejnë veten në pararojë të përpjekjeve të shoqërisë për të frenuar përhapjen e pandemisë Covid-19. Punonjësit e këtyre shërbimeve mund të kenë nevojë për vet karantinim në vazhdim, prandaj politikë-bërësit duhet të garantojnë pagën e të "sëmurëve" për këtë periudhë karantinimi në mënyrë që ata të mbrojnë veten dhe të gjithë ne.

Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) ka paralajmëruar se **COVID-19** mund të shkaktojë një recesion ekonomik të ngjashëm me atë të vitit 2008. Ndërsa ndikimi i virusit përhapet më tej, dialogu ndërmjet sindikatave, punëdhënësve dhe qeverisë është me rëndësi jetike në mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe të drejtat e tyre në punë. Nevoja që qeveria të veprojë së bashku me këta aktorë për të ngritur ekonominë dhe për t'i mbajtur njerëzit në punë është e qartë. Prandaj Sindikata e Punonjësve të Postë-Telekomit Shqiptar për të gjithë punonjësit e këtij sektori i bën thirrje:

- **Qeverisë:**

1. Të hartojë dispozita të posaçme për tu zbatuar nga punëdhënësit për të zgjatur menjëherë të drejtat e pushimit të paguar për punonjësit në rast të prekjës nga virusi ose karantinimit të detyruar.
2. Të zgjerojë mbrojtjen sociale për të gjithë punonjësit, pavarësisht nga statusi i tyre i punës (me kohë të plotë ose të pjesshme);
3. Në mbështetje të Nenit 48 Kodi i Punës pika 2 “ Mjedisi i Punës” , ku Këshilli i Ministrave përcakton masat që duhet të ndërmerret punëdhënësi, kërkojmë hartimin e masave mbrojtëse më specifike për punëdhënësit për të mbrojtur punonjësit.
4. Të vendos paketa stimuluese me shpenzimet shtetërore që synojnë të mbajnë punën dhe ekonominë, duke mbrojtur pagat, mirëqenien e punëtorëve dhe të bizneseve që do të preken nga mungesa e fuqisë punëtore.
5. Të bashkëpunojë me punëdhënësit dhe sindikatat për të hartuar lehtësime fiskale në mënyrë që punëdhënësit t'i përgjigjen kërcënimeve të paraqitura nga COVID-19 dhe të sigurojnë që punëtorët e tyre janë të mbrojtur dhe nuk përbëjnë rrezik për shoqërinë.

- **Punëdhënësve:**

1. Punëdhënësit e këtij sektori duhet të sigurojnë që punëtorëve t'u jepen mjetet e nevojshme cdo ditë që paraqiten në punë (dorezat,maskat,disinfektantët etj) për të garantuar sigurinë e tyre dhe atë të publikut të gjerë.
2. Të garantojë sigurinë e gjithë punonjësve duke disinfektuar ambientet e punës, ajrosur, respektuar distancën në vendin e punës, krijuar kushte për higjienën personale dhe t'u sigurojnë atyre informacionin për sa i përket pajisjeve që përdorin;
3. Trajnimi i punonjësve në lidhje me masat që duhet të marrin për Covid 19, që të kuptojnë rreziqet me të cilat përballen dhe besimin në pajisjet e tyre.
4. Të promovojnë punën nga shtëpia (online) sa më shumë të jetë e mundur.
5. Punonjësit me risk të lartë ose me sëmundje kronike të kenë orare të reduktuara ose mundësisht të punojnë nga shtëpia.
6. Të hartohen masa që në pikat e shërbimit për publikun të evitohet kontakti dhe grumbullimi i njërëzve.
7. Të mbulohen me pagë të plotë punonjësit që mund të preken nga Covid 19 ose duhet të karantinohen.
8. Të mundesohet që një nga prindërit me fëmijë të vogël të qëndrojnë në shtëpi gjatë periudhës kur shkollat do të jenë të mbyllura.
9. Privatësia dhe informacioni personal i punonjësve duhet të mbrohen pasi ato i nënshtrohen ekzaminimeve mjekësore nga COVID-19.
10. Të bashkëpunojnë me sindikatat dhe përfaqësuesit e punonjësve për të identifikuar kërcënimet ndaj shëndetit, të drejtave dhe mirëqenies së punonjësve.


Mos harroni që punonjësit e sektorit tonë janë në vijën e parë të ndikimeve ekonomike, sociale dhe shëndetësore të COVID-19. Marrëveshjet kolektive sigurojnë kontekstin gjithëpërfshirës dhe të adaptueshëm për marrjen e këtyre vendimeve të përbashkëta. Mos respektimi i tyre mund të rrisë përhapjen e virusit!
Të gjithë sëbashku do ta kalojmë këtë situatë!

SINDIKATA E PUNONJESVE TE POST-TELEKOMIT SHQIPTAR

TAKIME NGA AKTIVITETETI SINDIKAL I SPPTSH-se GJATE VITIT 2020-2021

TAKIM ME PERFAQESUESIT E SINDIKATES SE KOSOVES FSP-PTK

Ne takimin e zhvilluar nga sindikata jone dhe sindikata e Telekomit te Kosoves Fsp Ptk Profili Zyrtar ne date 17.09.2020 me teme "Dialogu Social dhe bashkepunimi rajonal ne sektorin e Telekomunikacionit, u diskutua mbi forcimin e bashkepunimit rajonal midis dy sindikatave tona. Kryetari i SPPTSH Z. Mucaj dhe kryetari i FSP-PTK z. Balaj u zotuan per te intesifikuar dhe kordinuar veprimtarine sindikale!



TAKIM ME SOLIDARITY CENTER

Në datën 26/01/2021 u zhvillua një takim online midis përfaqësuesve të SPPTSH-së dhe drejtorit Rajonal të Qendrës së Solidaritetit të konfederatës amerikane AFL- CIO, Steven McCloud. Gjatë takimit delegacionet diskutuan për programet e zhvilluara me Qendrën e Solidaritetit Z. Mucaj, u shpreh i kënaqur për ekspertizën që Qendra ka dhënë në trajnimin e përfaqësuesve të sindikatës dhe i kërkoi Qendrës vazhdimin e bashkëpunimit. Z. Steven konfirmoi që qendra do ta mbështes sindikatën dhe do vazhdoj bashkëpunimin strategjik midis organizatave.

TAKIM NE AMBASADEN SUEDEZE.

Në Ambasadën Suedeze, me 26 Shkurt 2020 u organizua nje takim me ambasadoren znj. Elsa Håstad dhe stafin e ambasadës ne nje diskutim për të drejtat e punës në Shqipëri, Gjate ketij takimi u diskutua mbi Kontratat kolektive dhe Sindikatat. Ky takim u organizua nga fondacioni suedez OPC ku pjesemarrësit ndane eksperiencat e tyre ne lidhje me te drejtat e punes ne Shqiperi.



SPPTSH DEKLARATË SOLIDARITETI

Ne 13 Prill 2020 kemi zhvilluar nje mbledhje te keshillit kombetar te sindikates online! Te gjithe perfaqesuesit diksutuan dhe sollen raportimet e tyre ne lidhje me seksionet dhe rajonet qe perfaqesojne mbi situaten qe punonjesit po kalojne nga pandemia Covid 19. Keshilli Sindikates vendosi ne kete mbledhje per miratimin e vendimit per te kontribuar ne kuadrin e pergjegjesise sociale per te ndihmuar disa familje ne nevojë ne programin e Diela Shqiptare qe transmetohet ne televizionin kombetar TV Klan.

TAKIME NGA AKTIVITETETI SINDIKAL I SPPTSH-se GJATE VITIT 2020-2021

VIDEO FALENDERUESE PER SAKRIFICEN E PUNONJESVE TE SEKTORIT TE TELEKOMUNIKACIONIT

Me 16 Prill 2020 SPPTSH ka publikuar nje video ne rrjete sociale per te shprehur mirenjohjen per te gjithë punonjesit e sektorit te telekomunikacionit, call center dhe sherbimit postar por vecanerisht nje falenderim per punonjesit e shitjes, punonjesit e shperndarjes dhe tekniket e rrjeteve te telekomunikacionit qe kane qene gjithë kohes ne terren per te na garantuar komunikimin qe eshte aq i rëndesishem keto dite. Per ne ata jane heronjte e heshtur, prandaj i kemi bere apel si Qeverise dhe Punedheneseve qe sakrificen e tyre ta shperblejne si moralisht dhe financiarisht!

SPPTSH PRONONCIM PER CALL CENTER NE "SCAN TV"

11 Prill 2020 - Kryetari i Sindikates z. Renato Mucaj, ka folur ne nje interviste ne Televizionin SCAN ne emisionin PERTEFOL, ne nje interviste me gazetarin Eri Saraci per te diskutuar mbi problematikat e në sektorin e telekomunikacionit, postave dhe call center gjate pandemise.

7 TETOR - DITA BOTËRORE PËR "PUNËN E DENJË",

SPPTSH dhe Olof Palme International Center – kanë publikuar një video për të shpjeguar dhe sensibilizuar të gjithë punëtorët për 7 Tetorin - Dita Botërore për "Punën e Denjë", ku sindikatat dhe punëtorët duhet të luftojnë për të promovuar idenë e punës së denjë. Sindikatat sot më shumë se kurrë po e përqendrojnë punën e tyre në kerkim të të drejtave thelbësore për punonjësit e vijës së parë të cilët ishin ata që vunë jetën në rrezik gjatë pandemisë Covid-19.

GËZUAR 8 MARS -IN - DITA NDËRKOMBËTARE E GRUAS!

Ne i japim shumë rëndësi vajzave dhe grave në sindikatë, që të jenë sa më të përfaqësuar. Si nje forcë e padiskutueshme e ambienteve tona të punës ato kanë qenë dhe do të jenë gjithmonë në qender të vëmendjes sonë. Me rastin e festes se 8-Marsit, Sindikata Poste Telekomit Shqiptar, organizoi nje aktivitet sensibilizues per te drejtat e grave ne pune dhe rritjen e angazhimit te tyre ne sindikate. Aktiviteti u zhvillua tek Kinema "Imperial", ku te gjitha anetaret e sindikates kaluan me pas nje pasdite te kendshme ne shoqerine e filmit komedi "Like A Boss" te mundesuar nga sindikata. Gjate ketij aktiviteti sindikata prezantoi dhe uroj të gjitha anëtarët tona per kontributin e tyre që kanë dhënë ndërvite me ane te nje videoje permbledhese.





Ne kuader te pergjegjesise sociale sindikata jone eshte solidarizuar per te ndihmuar familjet ne nevoje ne kete kohe pandemie me programin “E diela shqiptare” dhe me Bashkine e Tiranës. Faleminderit ekipit te sindikates dhe te gjithe anetareve tane! Emisionin e gjeni ne kanalın RTV KLAN ne YOUTUBE.





ANKETIM: SEKTORI I CALL CENTER DHE PROBLEMATIKAT GJATE PANDEMISE.

Ne kuader te fushates dixhitale te SPPTSH ne bashkepunim me Olof Palme International Center - Albania Programme SPPTSH ka organizuar nje anketim per te gjithe punonjesit e Call Center-ave qe te japin feedback-un e tyre ne lidhje me ceshtjet qe duhet te merren parasysh gjate trajtimit te problematikave me institucionet pergjegjese. Ky anketim kishte per qellim te analizoje situaten e krijuar gjate COVID 19.



**STAND
TOGETHER**

by not

**STANDING
TOGETHER**




ANKETIM


#SURVEY #CALLCENTERWORKERS

Pjesëmarrja në këtë anketim ishte
KONFIDENCIALE!


Gjinia juaj ?




Prej sa kohesh punoni ne te njejten kompani?




A punoni Part Time / Full Time ?




Gjinia juaj ?



A keni punuar gjate periudhes se Pandemise ?



A ka marr kompania juaj masat mbrojtese per punonjesit ne vendin e punes ? (nese keni informacion dhe keni shkuar ne pune)



A e keni marre te plote pagen e muajit Mars ?




jane marre ne kohe, duke na pajisur me maska, doreza dhe disinfektant dhe duke na matur temperaturen cdo dite kur hynim ne pune.


- Jemi pezulluar deri me 31 maj . ndihme ekonomike ose thjesht te hapi punen qe te punojme
- Qe te mos na pezullojn por te na jepet mundesi te punojm nqs edhe nga shtepia
- Minimalisht te shtohet e plote paga ,bashke me bonuse/dieta etj... ose te mundesojne kushtet per te punuar ne kompani
- Kerkoje qe kompania ime te hapet dhe te fillojm punen se u bera 1 muaj e gjysem pa punë.
- Ti rikthehem i punes
- Un thjesht pretendoj qe te rikthehem ne pune ne momentin qe do hapet kompania. Dhe te jem pjese serish te paguhem sepse nje pjese e jona jemi papune edhe nje pjese po punojne nga shtepia thjesht minimumi te marrim rroge te gjithë njesoj mos ngelet njeri pa pune
- Te paguhem si me pare
- Ne fillim te muajit prill na informuan qe do te nderpritet mardhenia e punes deri ne momentin sa te stabilizohet situata. Me vone na informuan qe kompania nuk aplikone per paketen perfituse.
- Nga qeveria kerkoj te mbikqyre punedhënesin tim dhe ta detyroj te na paguaj ditet qe na ka hequr gjate ksaj lufte . Dy javorshin e par te karantines nuk kemi punuar . Pas 2 javesh filloj puna ne shtepi. Por, pagesa e muajit mars eshte bere vetem per ditet qe kemi qen ne pune. Ndersa, ne prill nuk na pagoheshin oret e punes por vetem bonuset dhe pse pronaret ushtronin presion tek operatorët te ishin disponibel n kohën e plot dhe pse nuk paguheshin oret .
- Ateher ne rradhe te pare faleminderit per mundesine qe po na jepni te shprehim shqetësimin tone lidhur me ket ceshnje .ajo qe un kerkoj. Nga kompania ku punoj ose qeveria eshte qe te me jepet mundësia te rikthehem serish ne vendin tim te punes edhe te paguhem per sherbimin qe ofroj sot ne jemi ne shpi te pa informuar se cdo behet me azienden ku un bej pjese qe aktualisht eshte e mbyllur nga qeveria kerkoj minimumi nje rroge derisa te mbyllet dhe kjo gjendje e jashtezakonshme. E cila ka krijuar panik jo pak per secilib prej nesh frika mos me mbetesh pa pune eshte me kryesorja

- Qe te mbeshtesi kompanin financiarisht nese eshte e nevojshme, ne menyre qe kompania mos te falimentoj dhe ne te humbasim vendin e punes ne kete kohe krize.
- Te paguhem kontributet te plota dhe te respektohen kushtet e kontrates nga te 2 palet.
- Ju faleminderit serish qe na dhatë mundesine qe te ngreje zerin nepermjet kesaj kauzen e cila mendoj do jet shume thelbësore shpresojme qe te mirpresim lajme pozitive ne keto kohe qe po jetojne se pervec epidemisë aktuale eshte edhe nje tjt ajo epidemia e pushtetit.


Cilet nga keto element do te doje te permiresohesh ne vendin tuaj te punes ?



1. A e dini se cfare eshte sindikata?



A e dini se pervec kontrates individuale me punedhënesin mund te nenshkruhet edhe kontrate kolektive qe negociohet nga sindikata?



PRONONCIM PER MEDIAT PROBLEMATIKAT NE SEKTORIN CALL CENTER



#CallCenter #Skema #TopChannelNews

Top Channel/Skemat e mashtrimit me Call Center/ Shqipëria, “oazi” i mashtrimeve që zhvatin individët

- Sot pas dy vitesh një pjesë e operatorëve telefonik janë kthyer në zyra, kreu i SPPTSH thotë se këto kompani u kërkojnë punonjësve të respektojnë masa antiCovid, por jo të vaksinohen. “Pra kemi një inkurajim që punonjësit të vaksinohen, por një email zyrtarë që këto kompani t’ju kenë dërguar punonjësve të vet jo. Pra nuk kemi një detyrim që këta punonjës të vaksinohet. Momentalisht një pjesë e punonjësve po punojnë në zyra, por pjesa më e madhe vazhdon të punojë nga shtëpia. Ato kompani që kanë hapur dyert janë duke respektuar protokollin e ministrisë së shëndetësisë, por duhet të them që punonjësit e call centrave punojnë të gjithë në zyra të hapura dhe mundësia e infektimit është tepër e lartë”.

- Shqipëria është kthyer në vendin ideal për të hapur kompani si ajo e “Ujikut të Uoll Stritit”. Skemat e mashtrimit ndryshojnë, por qëllimi mbetet i njëjtë: zhvatja e parave të qytetarëve. Nëpërmjet platformave të rreme, operatorët apo të ashtuquajturit agjentë financiarë bindin qytetarë të investojnë mijëra euro duke i premtuar fitime mararamendëse. Ata prezantohen si këshillues financiarë, të cilët do t’i shumëfishojnë paratë e tyre në bursa dhe një ditë platforma mbyllet dhe zhduket bashkë me paratë. Pavarësisht, joshjes operatorët duhet të qendrojnë larg këtyre kompanive dhe të punojnë me call centra të cilat zhvillojnë aktivitete legal.

A E DINË PUNONJËSIT E QENDRAVE TË THIRRJEVE NË BALLKANIN PERËNDIMOR KË TË TELEFONOJNË?



Qendrat e Thirrjeve (Call Center) janë një sektor dinamik në rajon me një ndikim të rëndësishëm në ekonomi dhe në sektorët kryesorë të punësimit, veçanërisht për të rinjtë. Për ta bërë këtë mundësi të qëndrueshme në afat të gjatë, duhet të përmirësohen kushtet e pagave dhe të punës. Olof Palme Center dhe Friedrich Ebert Stiftung mblodhën sindikatat nga ballkani perëndimor dhe nga e gjithë Evropa për të shkëmbyer përvoja dhe për të diskutuar sfidat për organizimin kolektiv dhe forcimin e fuqisë së sindikatave për të ndikuar dhe përmirësuar kushtet e punës dhe politikat që lidhen me sektorin. Në këtë aktivitet sindikata jonë u përfaqësua nga Kryetari z. Renato Muçaj dhe Sekretarja Organizative znj. Irida Marku.

ECONOMY FOR ALL

Programi “Economy for all” është një iniciativë e Fondacionit “Friedrich Ebert” që synon të ridimensionojë rolin e aktorëve ekonomikë dhe shoqërorë për të hedhur bazat e krijimit të një modeli të ri social-ekonomik. Në 19 Tetor 2021 u prezantuan dy studime dhe një desk research, përkatësisht mbi:


- > “Sistemi ekonomik dhe roli i shtetit në shoqëri” – Opinione dhe qendrimet e publikut shqiptar
- > “Produktiviteti: Thembra e Akilit në Ekonominë Shqiptare”
- > “Politikat e industrializimit”

Këto botime pasurojnë jo vetëm zinxhirin e kërkimeve mbi ekonominë për ekonomistë apo ekspertë të fushës, por gjithashtu për përfaqësues të bizneseve, shoqërisë civile, studentë dhe akademikë që e shohin ekonominë të lidhur ngushtë me të gjitha proceset demokratizuese. Politikbërësit, ku disa prej tyre ishin të pranishëm në aktivitetin e organizuar nga FES, kanë një rol kyç në mundësimin dhe zbatimin e rekomandimeve të këtyre punimeve në përmirësimin e klimës së biznesit, barazisë ekonomike e sociale, mbështetje dhe investime në inovacion, në arsim, infrastrukturë etj.



SHITJA E ALBTELECOM?

Mbas marrjes se informacionit zyrtar mbi shitjet e 80.27% te aksioneve te Çalik Holding ne Albtelecom sh.a. te grupi Hungarez 4iG. SPPTSH filloj menjehere interesimin per te drejtat e punetoreve dhe se cfare eshte parashikuar per ta! Per kete arsye i jemi drejtuar kompanise Albtelecom me nje shkrese zyrtare, ku kemi kerkuar informacion si per shperblimin e fundvitit dhe per shitjen e kompanise. Duke qene se 4iG ka blere edhe nje operator tjetër ne tregun e telekomunikacionit kjo i shton akoma me shume shqetesimet per nje bashkim te mundshem te te dy kompanive cka mund te coj ne shkurtimin e vendeve te punes. Ne jemi duke i ndjekur me vemendje te gjitha zhvillimet si ne nivel kompanie dhe ne nivel sektori.



Ne jemi të bindur se duke u anëtarësuar në sindikatë, ju jo vetëm forconi sindikatën por ndihmoni për të tejkaluar çdo sfidë! #meneteparet.

KERKESAT E SPPTSH DHE PERGJIGJA NGA KOMPANIA

Gjithashtu bashkëngjitur do të gjeni dhe përgjigjen zyrtare të kompanisë Albtelecom në lidhje me shqetësimin e ngritur nga sindikata për termat dhe kushtet e punonjësëve, ku ato do të vazhdojnë të njëjta sipas kontratave individuale dhe kontratës kolektive në fuqi.





PJESEMARRJA E SPPTSH NE KONGRESIN E SINDIKATES TURKE HABER-IS NE ANKARA

Me ftesen e sindikates turke te telekomunikacionit HABER-IS, SPPTSH mori pjese ne kongresin e 14-te te sindikates te zhvilluar ne Ankara ne 16-17 Tetor 2021. Ne delegacionin Shqiptar merrnin pjese z. Renato Mucaj – Kryetar i SPPTSH, z. Lamih Balaj – Kryetar i FSP-PTK te Kosoves, z. Zenel Muca – zv.kryetar i SPPTSH-se dhe z. Naim Haliti zv. Kryetar i FSP-PTK. Kongresi 14. i Sindikates , u pershendet nga delegacione te shumta dhe sindikata simotra. Ne kongrese mbajti fjalen e tij dhe kryetari i konfederates me te madhe turke Haber-IS, z. Ergün ATALAY me te cilin patem nje takim te shkurter. Kongresi 14. i Haber-IS rizgjodhi ne krye te saj kryetarin aktual z. Veli Solak. Delegacioni Shqiptar i uroj z. Solak urime te perzemerta ne emer te sindikatave tona dhe e ftoj te jete i pranishem si ne Tirane edhe ne Prishtine.





AKTIVITET SOCIAL NE STAMBOLL PER ANETARET E ALBTELECOM, MAKHES & TELEPERFORMANCE

SPPTSH ka organizuar nje aktivitet “BrainStorming” me rastin e festive te Nentorit. Në kuadër të kesaj vizite në Stamboll u prit dhe nga Sindikata Turke e Telekomunikacionit - Haber IS-në zyrat e saj në Stamboll. Në këtë pritje ishin të pranishëm kryetari sindikatës z.Veli SOLAK, nënkryetarët z.Hüseyin ÖZÇOBAN, z.Gökhan AYDIN, z.Tagi İŞ, dhe Kryetari i Rajonit te Stambollit z.Nuh Galip TOPAK. Në këtë takim grupi i sindikatës sonë i cili përbëhej nga anëtarë të Albtelecom, Makhes dhe Teleperformance pati mundësinë të shkëmbej informacione dhe ndaj eksperiencave mbi punën e të dy sindikatave mbi organizimin sindikal, rekrutimin e anëtarëve dhe organizimin e sindikatave në call center, fushë e cila me ndryshimet e fundit ligjore i ka kaluar sindikatës së telekomunikacionit në Turqi. Kryetari i Sindikatës z. Renato Muçaj falenderoj kryetarin e Sindikatës Turke z.Solak dhe të gjithë kryesinë në emër të të gjithëve. Te dy sindikatat u zotuan për të shtuar akoma më shumë aktivitetet e ndërsjellta midis tyre. Gjatë vizites ne Stamboll grupi i SPPTSH pati mundësinë të kalonin kohë sebashku dhe të shijonin bukuritë që te ofron qyteti magjik i stambollit.

Se bashku na presin eksperiencat e bukura edhe ne vazhdim!





**NJË SINDIKATË
PËR TË GJITHË!**



**ANETARËSOHU
EDHE TI!**